



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA KOLONJE**

RAPORT TEKNIK

**RIKUALIFIKIM URBAN I BLLOKUT QE KUFIZOHET NGA
RRUGET "AHMET BEKTASHI", "MEHMET PEPI", "FAN
NOLI" SI DHE RIVITALIZIMI I PARKUT "RINIA", QYTETI
ERSEKE.**

ERSEKE 2019

1. HYRJE

1.1 Vendodhja e Objektit

Objekti: **Rikualifikim Urban i Bllokut qe kufizohet nga rruget "Ahmet Bektashi", "Mehmet Pepi", "Fan Noli" si dhe rivitalizimi i Parkut "Rinia", Qyteti Erseke** eshte nje projekt I cili perfshin nje pjese te qytetit te Ersekes, Bashkia Kolonje. Hartimi I ketij projekti ka ardhur si rezultat i investimeve qe po realizon Fondi Shqiptar I Zhvillimit ne kuader te programit "Infrastruktura Vendore dhe Rajonale", per vitin 2019. Nisur nga kerkesa per aplikim eshte hartuar nje projekt qe perfshin punime ne zonen e hyrjes se qytetit te Ersekes duke perfshire rruge, lulishte, fasada , ndertimi I linjes se KUZ per fazen e magjistralit dhe sistemime te jashtme.

Aktualisht ne qytetin e Ersekes eshte nisur projekti I linjes se re te ujesjellesit prej 2 muajsh I cili perfshin furnizim me uje te gjithe qytetit me linje te re tubacionesh. Nisur edhe nga hartimi I projektit te kanalizimeve per gjithe qytetin ne fazen e pare te magjistralit kryesor do te perfshihet ne kete projekt ndertimi vetem I linjes qe kalon ne keto rruge dhe lulishte. Realizimi I punimeve do te behet sipas projekt-preventivit te dorezuar ne bashki ne vitin 2018.

○ Zona qe perfshihet ne projekt

Qyteti i Ersekes ndodhet ne zonen juglindore te vendit ne distance rrugore 45 km ne jug te Korces. Kordinatat gjeografike te qendres se qytetit jane 40° 20' 19.7"N dhe 20° 40' 50.74"E.

Qyteti kufizohen nga fshatrat perreth :

-Lindje: *Rehove*


-Jug: *Agalli, Taci I siperm*

-Veri: *Bejkove*

-Perendim: *Kodras ,Lengez*

Plani I projektit perfshin konkretisht:

- Parkun Rinia
- Rruget Lidhese "Ahmet Bektashi", "Mehmet Pepi", "Fan Noli"
- Rikonstrukcionin I pjesshem i Fasadave te 4 objekteve
- Sistemim I rrugëve te brendshme te pallateve



2. INFORMACIONI PER ZONEN E PROJEKTIT

Ne hartimin e projektit eshte bere inspektimi I gjendjes ekzistuese te parkut, fasadave dhe rrugeve.

Problematikat kryesore jane:


A. Lulishtja

- Probleme sistemimi te konfiguracionit te ndertuar me demtime te dukshme te trotuarit, shatervanit dhe lapidarit.
- Problem sistemimi te pemeve dhe gjelberimit.
- Probleme Mjedisore dhe rreziqe higjenike ne lidhje me shkarkimin e patrajtuar te ujrave te perdorura;
- Probleme higjenike te pamjaftushmerise dhe papershtatshmerise se grumbullimit dhe heqjes te ujrave te perdorura;
- Permbytje te shpeshta nga shiu ne disa pjese te zones.

➤ Gjendja Ekzistuese



➤ **Propozimi**



B. Rruget lidhese

➤ **B.I RRUGA "AHMET BEKTASHI" L=200 ML**

- Probleme te paketave te shtreses asfaltike
- Demtim I rrjetit te ujrave te shiut dhe si rezultat ka nivele permbytje ne rruge.
- Problem me ndricimin rrugor te pamjaftueshem.
- Problem me kunetat dhe KUZ.
- Nuk ka linja te dedikuar te elektrofonit.
- Demtim trotuari dhe nevojë për sistemim.


➤ **Gjendja Ekzistuese**



➤ **Propozimi**

Punimet perfshijne :

- Heqje pakete asfaltike dhe riveshje te saj
- Trotuar I ri me pllaka me 6 cm beton
- Bordure, kunete dhe k.bordure
- Linje e re ndricimi
- Linje e re e KUB
- Linje e re e elektrike dhe elektrofonise



- **B.III RRUGA " FAN NOLI " L=210 ML**
- Probleme te paketave te shtreses asfaltike.
- Demtim I rrjetit te ujrave te shiut dhe si rezultat ka nivele permbytje ne rruge.
- Nuk ka ndricim rrugor te mjaftueshem.
- Problem me kunetat dhe KUZ.
- Nuk ka linja te dedikuar te elektrofonit.
- Demtim trotuari dhe nevoje per sistemim.


➤ **Gjendja Ekzistuese**



➤ **Propozimi**

Punimet perfshijne :

- Heqje pakete asfaltike dhe riveshje te saj
- Trotuar I ri me pllaka me 6 cm beton
- Bordure, kunete dhe k.bordure
- Linje e re ndricimi
- Linje e re e KUB
- Linje e re e elektrike dhe elektrofonise



C.RIKONSTRUKSIONI I FASADAVE

Eshte parashikuar nderhyrje ne 4 objekte sipas planit te meposhtem:

Objekti Nr.1 (5 K)

Objekti Nr.2 (4 K)

Objekti Nr.3 (2 K)

Objekti Nr.4 (3 K)


➤ Problematikat

- Degradim I jashtem I fasades.
- Demtim I tarraces dhe si rezultat ka lageshtire.
- Demtim I suvase dhe sistemit te shkarkimit te ujrave te shiut.

➤ Propozimi

Punimet perfshijne :

- Ndertim te catise se re
- Veshje me sistem kapote
- Plani i kullimit te ujrave te shiut.




➤ Gjendja Ekzistuese

Objekti nr.1 (5K)





➤ *Propozimi*



Objekti nr.2 (4K)



➤ *Propozimi*

PAMJA LINDORE




Objekti nr.3 (2K)



➤ *Propozimi*

I


PAMJA LINDORE



Objekti nr.4 (3K)



➤ *Propozimi*



➤ *Rruget Hyrese Te Pallateve*







➤ **Propozimi**



Punimet perfshijne :

- Germim mbushje per nivelim te rrugeve hyrese
- Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 3 cm, me makineri
- Shtrese binderi me granil gur kave, 5cm, me makineri
- Shtrese stabilizant t=10cm
- Shtrese çakelli mbeturine kave t=15 cm, perhapur e ngjeshur makineri
- Trotuar
- Bordure
- Plani i kullimit te ujrave te shiut.

Sh-1:50




PRERJE TERTHORE TIP C-C




D.TRASIMI I LINJES SE KUZ SIPAS PROJEKTIT TE HARTUAR NE VITIN 2018


Sipas planit te realizimit te ketij projekti eshte marr parasysh perfshirja e rikonstruksionit te magjistralit te linjes se kanalizimeve per fazen e pare. Ky projekt eshte hartuar dhe dorezuar ne Bashkine Kolonnje ne vitin 2018 I cili llogaritur per gjithe qytetin. Nisur nga projekti nje pjese e linjes se KUZ kalon edhe ne rruget qe do te nderhyet ,konkretisht ne rrugen “MEHMET PEPI” dhe rrugen “FAN NOLI” si dhe ne zonen e lulishtes.

➤ Plani Ekzistues I Kuz



➤ Plani i trasimit te KUZ sipas Projektit te ri





1. Tubacionet do dimensionohen me diameter fillestar nga Ø 315 mm dhe perfundojne me tub Ø 1200 mm ne kolektorin e fundit.

2. Diametrat e tubacioneve te perdorur jane:

- Ø 315 mm
- Ø 500 mm

3. Materiali I tubacioneve te ujrave te zeza eshte HDPE SN8.

Tubacionet HDPE jane te favorizuar ne avantazhe si me poshte:

- Jane rezistente ndaj korrozionit
- Jane fleksibel dhe duktil
- Kane jetegjatesi te madhe deri ne 50-100 vjet
- Pikat e bashkimit te tyre jane rezistente nqs bashkohen ne temperatura te larta
- Kane impakt te ulet ne mjedis
- Jane mjaft te lehte edhe per tu rehabilituar ne rast demtimesh

4. Pusetat qe do realizohen jane prej betoni me kapak gize .

Thellesia e kanaleve ne funksion te diametrave jane:

Thellesite e pusetave variojne nga 1.6 m minimum duke perfshire paketen asfaltike deri ne 6.77 m maksimumi .Vendosja e pusetave eshte realizuar ne perputhje me kushtet e BS EN 752 te distancave minimale dhe maksimale ne funksion te diametrit perkates te tubit .

Diameter of Pipe (mm)

Maximum Intervals (m)

≤675

80[#]

>675 and ≤1050

100

>1050

120


Seksioni minimal I germimit te pusetes ne rruget me asphalt fillon nga 1.6 m sipas detajit te meposhtem.



8. PLANIMETRIA E ZONES ME DEGEZIMET PERKATESE.

Planimetria e rrjetit perfshin rreth 19 degezime te tuabcioneve me diametra te ndryshem.

Seksionet e germimit tip te kanalit pergjate trasese jane:



9. PLANI I SHPRONESIMEVE.

Nderhyrjet per “RIKUALIFIKIM URBAN I BLLOKUT QE KUFIZOHET NGA RRUGET "AHMET BEKTASHI", "MEHMET PEPI", "FAN NOLI" SI DHE RIVITALIZIMI I PARKUT "RINIA", QYTETI ERSEKE”, nuk kerkojne shpronesime pasi pronat ku do te zhvillohen nderhyrjet jane toke shteterore, per me teper kemi te bejme vetem me punime rikualifikimi dhe rikonstruksioni ne gjurmet egzistuese te tyre si tek rruga Fan Noli dhe Ahmet Bektashi, ashtu dhe tek nderhyrjet ne Parkun Rinia te Qyteti, dhe tek Blloku i pallateve.